

## KONTRATA

Nr. 2618 dt. 02.11.2018

N.P.K. " TRAFIKU URBAN " SH.A. e perfaqesuar nga **Lulzim Rexhepaj** Kryeshef Ekzekutiv, (në vazhdim "Autoriteti Kontraktues"), në njëren anë; dhe **NTGI GRAFO-LONI** me numer fiskal **600192752** e perfaqesuar nga **Nazim Pireva** (në vazhdim "Operatori Ekonomik"), ne anën tjetër, janë pajtuar te lidhin një kontrate publike për: **Furnizim me uniforma për shofer dhe kondukter. Furnizim me këmisha dhe kravata ( kollare )** me numër Identifikues **TU-18-7424-1-3-6**.

### **Neni 1 Lënda**

- 1.1 Lënda e kontratës do të jetë furnizim me **600 copë këmisha dhe 200 copë kravatë kollare**.
- 1.2 Kontrata hynë në fuqi me **02.11.2018** dhe përfundon me **02.11.2019**.
- 1.3 Afati kohor i performances nuk mund të jetë më shumë se **7** ditë nga data e marrjes së urdhëreses.
- 1.4 Vendi i **dërgimit të furnizimeve** do të jetë **depo e Trafikut Urban**.
- 1.5 Incotermi i aplikueshëm do të jetë **DDP<sup>1</sup>** (Detyra e Dërguar e Paguar).

### **Neni 2 Ligji i aplikueshëm**

2.1 Ligji i zbatueshëm do të jetë sipas Nenit 40 të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092 Për çështjet që nuk mbulohen me dispozita të kontratës, zbatohen ligjet në fuqi në Kosovë. Juridiksioni do të jetë gjykata përkatëse në Prishtinë.

### **Neni 3 Çmimi**

- 3.1 Çmimi total i kontratës do të jetë: **5900.00 €; pesë mijë e nëntëqind Euro**.
- 3.2 Çmimi i përmendur në Nenin 3.1 më sipër duhet të jetë e vetmja pagesë që Autoriteti Kontraktues i ka borxh Operatorit Ekonomik sipas kontratës. Ai duhet të jetë i prerë dhe të mos i nënshtrohet ndryshimeve gjatë ekzekutimit të kontratës (në përjashtim të çmimeve të atyre artikujve që i nënshtrohen ndryshimit të çmimit sipas berzës përkatëse, nëse aplikohet).

### **Neni 4 Pagesat**

- 4.1 Pagesa do të bëhet në Euro.

#### **Autoriteti Kontraktues do të paguaj secilën shumë të detyrimeve pas pranimit të secilës dërgesë**

4.2 Pagesat e detyrimeve sipas një fature të lëshuar nga Operatori Ekonomik duhet të paguhet brenda jo më shumë se 30 ditësh nga data në të cilën kërkesa e pranueshme për pagesë është regjistruar nga departamenti përkatës. Data e pagesës do të jetë data në të cilën debitet llogaria e institucionit. Kërkesa për pagesë nuk do të jetë e pranueshme nëse nuk plotësohen një ose më shumë nga kërkesat thelbësore.

---

<sup>1</sup> DDP – Detyra e Dërguar e Paguar- Incoterms 2010 Oda Ekonomike Ndërkombëtare

#### **Neni 5 Marrëveshjet lidhur me tatimin dhe doganën**

5.1 Operatori Ekonomik është përgjegjës për të gjitha detyrimet dhe taksat në përputhje me Ligjin e Republikës së Kosovës.

5.2 Të gjitha taksat dhe detyrat e tjera doganore konsiderohen se janë të përfshira në çmimin e kontratës.

#### **Neni 6 Kualiteti**

6.1 Kualiteti i [furnizimeve] duhet në të gjitha aspektet të plotësoj specifikimet teknike të parashtruara në Dosjen e Tenderit.

#### **Neni 7 Garancioni**

7.1 Garancioni do të mbetet valid për 12 muaj, pas pranimit të [furnizimeve].

#### **Neni 8 Vonesat në ekzekutim**

8.1 Nëse Operatori Ekonomik me përgjegjësinë e tij nuk arrin [t'i dorëzojë ndonjë ose të gjitha mallrat] brenda limiteve kohore të specifikuara në kontratë, Autoriteti Kontraktues, pa njoftim zyrtar dhe pa paragjykim ndaj kompensimeve tjera të tij sipas kontratës, do të ketë të drejtë, për secilën ditë që kalon ndërmjet skadimit të periudhës së kontratës dhe datës aktuale të përfundimit, t'i marrë dëmet e likuiduara të barabarta me 0,25% në ditë të vlerës së [furnizimeve] të pa dorëzuara deri në një maksimum prej 10 % të vlerës totale të kontratës.

#### **Neni 9 Inspektimi dhe testimi**

9.1 Autoriteti kontraktues do të ketë të drejtë që herë pas here të inspektojë, kontrollojë, masë dhe testojë komponentët, materialet, dhe mjeshtrinë, dhe të kontrollojë përparimin e përgatitjes, fabrikimit apo prodhimit të çfarëdo artikulli që përgatitet, fabrikohet ose prodhohet për t'u dorëzuar sipas kontratës, në mënyrë që të përcaktojë nëse komponentët, materialet dhe mjeshtrëria kanë cilësinë dhe sasinë e kërkuar.

#### **Neni 10 Nën-kontraktimi**

10.1 Një nënkontratë do të jetë e vlefshme vetëm nëse është një marrëveshje me shkrim me të cilin Operatori Ekonomik i beson kryerjen e një pjese të kontratës së tij një pale të tretë. Operatori Ekonomik nuk duhet të nënkontrakttojë pa autorizim paraprak me shkrim nga Autoriteti Kontraktues. Autoriteti Kontraktues do të njoftojë Operatorin Ekonomik për vendimin e tij brenda 5 ditëve nga marrja e njoftimit, duke i paraqitur arsyet e veta nëse nuk lëshohet autorizimi.

#### **Neni 11 Ndërprerja e Kontratës nga Autoriteti kontraktues**

11.1 Autoriteti kontraktues mundet që, pasi t'i japë Operatorit Ekonomik shtatë ditë paralajmërim, ta ndërpresë kontratën në ndonjërin nga rastet në vijim: a) Kur operatori ekonomik nuk arrin t'i realizoj obligimet e veta sipas kontratës; b) Dështon në ekzekutimin e kontratës në afatin e caktuar; c). Refuzon urdhrat administrativ të autoritetit kontraktues; d) Ia jep dikujt kontratën apo nënkontratën pa autorizim nga autoriteti kontraktues; e). Falimenton; f). Është dënuar nga një gjykatë për një shkelje që ka të bëjë me sjellje profesionale, përmes një gjykimi që ka fuqinë e *res-judicata*; g) Operatori ekonomik i është nënshtruar një gjykimi që ka forcën e *res judicata* për mashtrim, korrupsion, përfshirje në ndonjë organizatë kriminale ose ndonjë aktivitet tjetër ilegal që i dëmton interesat e përgjithshme financiare; h) shfaqet ndonjë paaftësi tjetër ligjore që i pengon realizimit të kontratës.

#### **Neni 12 Ndërprerja e Kontratës nga Operatori Ekonomik**

12.1 Operatori Ekonomik, pasi e ka paralajmëruar Autoritetin Kontraktues 14 ditë paraprakisht, mund ta ndërpresë kontratën nëse Autoriteti kontraktues: a) Nuk arrin t'i paguajë Operatorin Ekonomik shumën që duhet të paguhet brenda periudhës së saktësuar me kontratë; b) vazhdimisht nuk arrin t'i plotësojë obligimet e veta me kontratë; c) si rezultat i forcës madhore, Operatori Ekonomik nuk është në gjendje për të kryer një pjesë materiale të kontratës për më shumë se 180 ditë, për arsye që nuk janë specifikuar në kontratë ose që nuk i atribuohen të Operatorit Ekonomik.

### Neni 13 Zgjidhja e mosmarrëveshjeve me procedurë gjyqësore





13.1 Nëse nuk mund të arrihet zgjidhje brenda 30 ditësh nga fillimi i procedurës miqësore për zgjidhje të mosmarrëveshjes, secila palë mund të kërkojë ose vendim nga gjyqi, ose vendim arbitrimi.

13.2 Çdo mosmarrëveshje ndërmjet palëve të cilat mund të lindin gjatë ekzekutimit së kësaj kontrate dhe se nuk është e mundur të zgjidhet ndryshe ndërmjet palëve do të dorëzohet në *gjykatën kompetente* në pajtim me ligjin e Kosovës.

### Neni 14 Komunikimi

14.1 Çdo komunikim me shkrim në lidhje me këtë Kontratë ndërmjet Autoritetit Kontraktues dhe Operatorit Ekonomik duhet jap Titullin e kontratës dhe numrin ei identifikimit, dhe duhet të dërgohet me postë, faks, e-mail ose me dorë.

E hartuar në gjuhën [Shqip]<sup>2</sup> në tri origjinale, dy origjinale për Autoritetin Kontraktues dhe një origjinal për Operatorin Ekonomik.

Për Operatorin Ekonomik		Për Autoritetin Kontraktues	
<b>Emri:</b>	Nazim Pireva	<b>Emri:</b>	Qendrim Vitija
<b>Pozita:</b>	Pronar	<b>Pozita:</b>	Zyrtar Përgjegjës i Prokurimit
<b>Nënshkrimi:</b>		<b>Nënshkrimi:</b>	
<b>Data:</b>	02.11.2018	<b>Data:</b>	02.11.2018
<b>Vula:</b>		<b>Vula:</b>	

<sup>2</sup> Gjuha do të jetë gjuha e përdorur nga tenderuesi në tenderin e tij.



Numri i Prokurimit: TU-18-7424-1-3-6 – Titulli Furnizim me uniforma për shofer dhe konduktër.  
Furnizim me këmisha dhe kravata ( kollare )

## Aneksi 2. DEKLARATA NËN BETIM

Unë, i poshtë nënshkruari, duke përfaqësuar: NTGI GRAFO-LONI deklaroj nën betim se jam i përshtatshëm në përputhje me Nenin 65, të Ligjit mbi Prokurimin Publik në Kosovë, Ligji Nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092.


Unë vërtetoj se i kam lexuar kërkesat e përshtatshmërisë në Nenin 65 të LPP-së, respektivisht seksionin III.1 të Informacionit për Tenderuesit, dhe vërtetoj se i përmbush kërkesat e përshtatshmërisë për pjesëmarrje në këtë procedurë të prokurimit.

Unë pranoj mundësinë e sanksionimeve penale dhe civile, gjobave dhe dënimeve, nëse unë për shkak të pakujdesisë dorëzoj çfarëdo dokumenti ose deklaratë që përmban informata përmbajtësive të gabueshme ose mashtruese.

Identifikimi i Operatorit Ekonomik (OE)	
Emri i OE:	NTGI GRAFO-LONI
Adresa e plotë:	RR. HALIL ALIDEMA
Përfaqësuar nga:	
Emri	NAZIN PIREVA
Pozita	PRONAR
Nënshkrimi	
Data	10.10.2018
Vula	

Numri i Prokurimit: TU-18-7424-1-3-6 – Titulli Furnizim me uniforma për shofer dhe kondukter.  
Furnizim me këmisha dhe kravata ( kollare )

**Aneksi I. SPECIFIKIMET TEKNIKE TË DETYRUESHME**

Artikulli	Përshkrimi	Ilustrimi
1	<p><b><u>KËMISHA-600 copë</u></b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Mëngjë të gjata me jaka.</li> <li>• Ngjyra e bardhë.</li> <li>• Materiali nga i cili është prodhuar duhet të jetë 70-100 % pambuk.</li> <li>• Një xhep të përparshëm në krahe të majtë.</li> <li>• Lloji i pullave në qendër përpara me distancë përpara sërisht 6-8cm.</li> <li>• Madhësia S,M,L,XL,XXL,XXXL</li> <li>• Që mund të lahen në lavatrice.</li> </ul> <p><b><u>KRAVATË-KOLLARE- 200 copë</u></b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• 70-100% mëndafsh.</li> <li>• Gjerësia në pikën më të gjerë; 8.5 cm.</li> <li>• Gjatësia: 100-130 cm.</li> <li>• Ngjyra: E verdhë e mbyllët (ngjyrë ARI).</li> <li>• Llogo e Trafikut Urban e vendosur me qendrisje 40 cm nga fundi i kravatës.</li> </ul>	



# N.T.G.I. "GRAFO - LONI" SH.P.K

Nrb:70169344, Nrf:600192752, Mob:044/173 187

Për: N.P.K. " TRAFIKU URBAN " SH.A.

Nga: NTGI "Grafo Loni"

Data:10.10.2018

Tema: Deklarata e specifikacionit teknik


Ne NTGI GRAFO-LONI deklarojme se i permbushim te gjitha specifikat teknike te tenderit ne fjale TE PERMENDUARA NE ANEXIN 1 NE DOSJEN E TENDERIT ;

Nr. i Prokurimit <sup>1</sup>	TU-18-7424-1-3-6
Nr i brendshëm	TU-18-038-136

Titulli: Furnizim me uniforma për shofer dhe konduker. Furnizim me këmisha dhe kravata ( kollare )

PRA OFERTA JONE DO TE JETE E PRANUESHME TEKNIKISHT

Nazim Pireva,  
TGI "GRAFO-LONI" SHPK



# **N.T.G.I. "GRAFO-LONI" SH.P.K**

Nrb: 70169344, Nrf: 600192752, Mob: 044/173187

Për: N.P.K TRAFIKU URBAN L;;

Nga: NTGI "Grafo Loni"

Data: 10.10.2018

Tema: DEKALART E LIFERIMIT

**Duke ju referuar kerkesave ne dosjne e tenderit ;**

Nr. i Prokurimit <sup>1</sup>	TU-18-7424-1-3-6
Nr i brendshëm	TU-18-038-136

Titulli: Furnizim me uniforma për shofer dhe kondukter. Furnizim me këmisha dhe kravata ( kollare )

**NTGI GRAFO-LONI DEKLARON SE LIFERIMIN E  
E BEJME PER 7 DITE NGA MOMENTI I PRANIMIT TE  
POROSISE**

Nazim Pireva ,

NTGI "GRAFO-LONI" SHPK



**Pjesa II. PËRSHKRIMI I ÇMIMEVE**

Nr.	Titulli	Prodhuesit model	Vendi i origjinës	Shënim	Njësia matëse	Sasia	Çmimi për njësi	Vlera
	Furnizim me uniforma për shofer dhe konduktuer. Furnizim me këmbësia dhe kravata ( kollare )							
1.	Kemisha		KOSOVE	NTGI GRAFO-LONI	copë	600,00	7,00	4.200,00
2.	Kravata ( kollare ) me llogo qendrisese		KOSOVE	NTGI GRAFO-LONI	copë	200,00	4,00	800,00
							ÇMIMI	5.000,00
							TOTALI TVSh	900,00
							TOTALI	5.900,00